R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1905/1 prot. Tiranë, më 12.09.2024

Lënda: Mendim mbi projektligjin *"Për kontrollin e kufirit shtetëror"*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj nr. 9269/1 prot., datë 16.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1905 prot., datë 19.08.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin "*Për kontrollin e kufirit shtetëror*" (në vijim, *"Projektligji"*), si dhe Relacionin shoqërues.

Nga përmbajtja e tyre konstatojmë se hartimi i këtij projektligji vjen si domosdoshmëri e përafrimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar. Ndërkohë vërejmë se në Relacionin shoqërues nuk është përcaktuar shkalla e përfarimit si dhe nuk janë bashkëlidhur Tabelat e Përputhshmërisë me legjislacionin përkatës evropian (*rregulloret apo direktivat*), instrumente të cilat i vlerësojmë të rëndësishme dhe ndihmëse, në përcaktimin e një analize të detajuar të këtij harmonizimi, si dhe nevojës së ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore.

Ndërkohë konstatojmë se nga krahasimi dhe analizimi i përmbajtjes së projektligjit me ligjin nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar" i ndryshuar, një pjesë e dispozitave të këtij të fundit, dhe kryesisht Kreu III "Kontrolli kufitar" janë të njëjta me projektligjin e propozuar dhe shfuqizohen prej këtij të fundit. Ndërsa Kreu II/1 "Të dhënat e pasagjerit" vijon të mbetet në ligjin nr. 71/2016.

Për sa më lart, duke iu referuar edhe kësaj ndarje, meqenëse proceset përpunuese të të dhënave personale nga institucionet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kontrollit të kufirit, janë të një game të gjerë dhe ndërlidhen me njëri tjetrin, respektimi i parimeve dhe

standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale përbën një detyrim thelbësor. Në vijim, propozojmë të mbahen në konsideratë disa komente dhe sugjerime për Projektligjin si më poshtë vijon.

Në pikën 5, të nenit 9, të projektligjit është parashikuar mbledhja e të dhënave për identifikim dhe për qëllim të verifikimit kufitar të automatizuar. Në të gjithë përmbajtjen e projektligjit apo në përkufizimet e tij nuk është përcaktuar se çfarë kuptojmë me "v*erifikimit kufitar të automatizuar*". Për këtë arsye sugjerojmë të shtohet edhe shpjegimi i këtij togfjalëshi, në mënyrë që të jetë sa më i qartë kuptimi i tij.

Në shkronjën "ii", të pikës 3 të nenit 10, të projektligjit parashikohet se rojet kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar, të verifikojnë identifikuesin biometrik në çdo bazë të dhënash. Në këtë rast, mendojmë që legjislacioni nuk duhet të lejojë aksesin në mënyrë të përgjithshme pasi kjo, do të cenonte thelbin e së drejtës themelore për respektim e jetës private të individit. Vlerësojmë se duhet të respektohet parimi i mjaftueshmërisë së të dhënave dhe aksesi të kufizohej vetëm ***tek të dhënat e domosdoshme***, duke marrë masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë së të dhënave. Kësisoj, propozojmë që termi "*në çdo bazë të dhënash*" i përdorur në këtë nen, të zëvendësohet me baza specifike/konkrete që do të aksesohen, duke kufizuar nivelet e aksesit.

Më tej referuar pikës 2, të nenit 31 të projektligjit, sugjerojmë që në Rregulloren e Sistemit të Mbikëqyrjes së Kufirit, e cila do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, të parashikohet në mënyrë të detajuar, lloji dhe kategoria e të dhënave që përpunohen në sistem, si dhe elemente teknike, të drejtat e aksesit dhe institucionet/subjektet që do të aksesojnë në këtë sistem.

Në nenin 39 të projektligjit, në titullin e tij dhe në përmbajtje vlerësojmë të unifikohet terminologjia e përdorur duke hequr termat "*mbledhje dhe përdorim i të dhënave personale*" dhe zëvendësuar këto terma vetëm me termin "*përpunim i të dhënave personale"* duke qenë se ky i fundit i përfshin në vetvete edhe këto procese. Gjithashtu, ***në germën ç) të pikës 1, të këtij neni*** fjala "...*në kuptim*" të zëvendësohet me fjalën "...*për qëllim*".

Në vijim sugjerojmë që ***pika 1 dhe 3 e nenit 40 të projektligjit***, të riformulohet me këtë përmbajtje:

1. *Çdo subjekt të dhënash gëzon të drejtën të marrë nga nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave ose struktura përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale pranë Policisë së Kufirit dhe Migracionit, konfirmimin nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar ose jo, dhe, sipas rastit, të ketë akses tek të dhënat personale në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.*

3. *Subjekti i të dhënave gëzon të drejtat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të drejtën e ankimit dhe kompensimit të dëmit sipas legjislacionit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.*

Gjithashtu, duke qenë se në këtë projektligj parashikohet shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim edhe me agjenci ndërkombëtare, ***pas nenit 40 të projektligjit***, sugjerojmë të shtohet një nen për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, me këtë përmbajtje:

"Policia e Kufirit dhe Migracionit, lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale tek palët e treta, zbaton dispozitat dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale."

Së fundmi në tërësinë e këtij projektligji vërejmë se nuk shprehet qartë ***qëllimi i përpunimit të të dhënave personale nga ana e Policisë Kufitare dhe Migracionit.*** Për këtë arsye sugjerojmë që të shtohet një nen në këtë drejtim. Përcaktimi i qëllimit të përpunimit të të dhënave personale përbën një detyrim sipas parashikimeve të nenit 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" por njëkohësisht ky sugjerim vjen në linjë me nenin 87 të Rregullores 2019/1896 të Parlamentit Evropian, të cilën synon të përafrojë Projektligji sipas Relacionit bashkëlidhur tij.

Me reflektimin për sa më sipër, Projektligji konsiderohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi